



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 19 mars 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Shqipe Pantina dhe Xhevahire Izmaqi.

Në mbledhje morën pjesë: OSBE, OEO, KPSS, KDI, RTK, Radio Kosova, KosovaPress dhe Ekonomia online.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës;
3. Shqyrtimi i propozimeve për hartimin e draft-ligjit për transmetuesin publik të Kosovës;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2 . Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës**

**Nait Hasani** njoftoi komisionin që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, në Kuvend ka arritur më 21 shkurt 2018 dhe komisioni brenda afatit të përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit e shqyrton para miratimit në parim, gjithashtu ai njoftoi komisionin edhe për raportin preliminar të hartuar nga drejtoria për standardizim e Kuvendit.

Komisioni shqyrtoi raportin preliminar me vërejtjet e dhëna për P/ligjin në fjalë dhe konstatoi se me vërejtjet për P/ligjin, komisioni e procedon për miratim në parim dhe në procedurën e shqyrtimit të dytë do t'i inkorporon vërejtjet e dhëna në raport preliminar.

Komisioni miratoi unanimisht në parim P/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe nxori këtë,

### **R e k o m a n d i m**

1. Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, Nait Hasani, kryetar i komisionit.

### **Arsyetim**

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional shqyrton projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit, në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, vlerësojë se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

## **3. Shqyrtimi i propozimeve për hartimin e draft-ligjit për transmetuesin publik të Kosovës**

Komisioni filloi shqyrtimin e draftit të hartuar në punëtorinë tri ditore dhe propozoi ndryshimet dhe plotësimet për nenet si vijon:

**Neni 1.22.** Të shtohet Direktiva si përkufizim.

**Neni 4.** RTK, vepron si shërbim publik në fushën e radios, televizionit dhe mediave online???

**Neni 5.1.9.** në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe në bashkëpunim me korporatat transmetuese radio- televizive publike të vendeve fqinje dhe të tjera, e përkrah zhvillimin e projekteve ndër-**shtetërore** radio televizive;

**Neni 6 .1.2.** kryeredaktorët dhe redaktorët nuk duhet të kenë program në RTK.

**Neni 9. 11.** Kanalet kombëtare do të transmetohen në një hapësirë të mbuluar nga së paku 90% e territorit të Kosovës.

**Neni 10.** Çdo vit, në përputhje me planin e prodhimit programor të referuar në (nenin 23 të Direktivës së BE-së 2014/24) ??? të këtij Ligji, RTK do të shpallë ofertë për blerjen e materialeve audio-vizuale nga prodhuesit e pavarur, për shkak të vlerës artistike, kulturore, sociale e të tjera.

**(RTK i nënshtrohet direktivës evropiane 2014/24, neni 23 për blerjen e materialeve audio-vizuale nga prodhuesit e pavarur).???????**

**Neni 11.3.** Fushatat politike sipas këtij Ligji do të jenë mesazhet e **fushatës** politike (spotet) dhe format e tjera të **fushatës** politike, qëllimi i të cilës është të ndikojë në qëndrimin e votuesve në dhënien e votës së tyre në zgjedhje. **19.03.2018.**

### **Neni-12 Neni 12 – Neni 15 i Ligjit për RTK**

#### **Transmetimi i informatave dhe programeve me përmbajtje religjioze**

**Neni 13- Riformulimi nga RTK-ja:**

1. Mesazhet e promovimit të religjionit nuk lejohen në kanalet e RTK-së.
2. Mesazhet e promovimit të religjionit sipas këtij Ligji do të jenë reklama të paguara për komunitetet religjioze.

#### **Mbetet për diskutim**

**Neni 13 – Neni 16 i Ligjit për RTK**

**Neni 13. 2.** Koha e kushtuar prezantimit të kandidatëve dhe partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës ose Parlamentin Evropian??????? do të jetë i njëjtë për të gjithë dhe kushtet që do të vlejnjë për prezantimin e tyre, si pjesë e transmetimeve para-zgjedhore do të jenë të gjitha të njëjta.

**Neni 17.2.** Anëtarët e Bordit të RTK-së janë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: Kultura, arti, kinematografia, gazetaria, drejtësia, biznesi dhe menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, universiteti, media dhe teknikës. **Nga neni i ligjit në fuqi 25.3**

**Neni 18.2.** Anëtarët e Bordit të RTK-së janë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: Kultura, arti, kinematografia, gazetaria, drejtësia, biznesi dhe menaxhmenti, marrëdhënie me

publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, universiteti, media dhe teknikës. **Nga neni i ligjit në fuqi 25.3**.

**Neni 18.8.** Anëtarëve të Bordit u ndalohet përfitimi personal apo të familjes së tij të ngushtë.

**Neni 19** . Mandati i anëtarëve te bordit mbetet për diskutim????

4. Anëtarët e Bordit do të zgjedhin mes tyre kryetarin dhe nënkryetarin e Bordit të RTK-së.

5. Mandati i kryetarit dhe nënkryetarit të Bordit të RTK-së është 2 (dy) vjet, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

6. Anëtari i Bordit, mandati i të cilit ka pushuar shkakun i mos përmbushjes së kushteve për emërimin ose zgjedhjen, ose të cilët kanë dhënë dorëheqje, **ose janë shkarkuar**, do të rregullohet me dispozitat e këtij Ligji.

**Neni- 20.1.9.** pronarët apo bashkëpronarët e mediave transmetuese **ose bizneseve reklamuese** si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre apo edhe të punësuarit në këto media; **mbetet për diskutim ???**

**Konstatim:** Komisioni ka vendosur për mbledhjen e radhës të shqyrtojë draftin për nenet në vijim.

Mbledhja përfundoi në orën:12:15.

**E përgatiti:**

**Stafi Mbështetës i Komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

-----

Nait Hasani